



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme
e Policisë së Kosovës

Nr. 01/0426 Prot, datë 30.06.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
së Shtetit

Nr. 4908/3 Prot, datë 30.06.2017

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR

ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA TË POLICIMIT RRUGOR MES
POLICISË SË KOSOVËS DHE POLICISË SË SHQIPTAR,
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Të vetëdijshëm për rëndësinë dhe nevojën e bashkëpunimit mes dy agjencive policore në fushën e trafikut rrugor për parandalimin e shkeljeve dhe rritjen e Sigurisë Rrugore;

Nisur nga fakti se, gjatë sezonit turistik Qershor – Shtator 2017, ka një rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve nga Kosova, që vijnë për pushime në zonat turistike të Shqipërisë, si dhe një numër mjetesh rrugore të Kosovës që qarkullojnë në akset kryesore rrugore që lidhin të dy vendet tona;

Me synim, intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe për të forcuar bashkëpunimin midis Policive të dy vendeve, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të planeve dhe masave të përbashkëta;

Me qëllim, vendosjen e bashkëpunimit konkret për: parandalimin e shkeljeve administrative në fushën e trafikut rrugor, uljen e numrit të ngjarjeve rrugore dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit rrugor, krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët dhe përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet;

Në funksion të përmbushjes së detyrave institucionale, për të mundësuar arritjen e synimeve të sipërpërmendura, nëpërmjet një bashkëpunimi ndër-institucional dhe ndër-policor;

Bazuar në ligjin nr.108/2014 i ndryshuar "Për Policinë e Shtetit", ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" dhe ligjin "Për Policinë" nr. 04/L-076, i datës 02.03.2012 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Palët kanë rënë dakord si vijon

Neni 1

1. Policia e Kosovës (në vijim pala dërguese) adresa në: Rr. "Luan HARADINAJ" nr.101 Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Shpend MAXHUNI, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës
dhe
2. Policia e Shtetit të Shqipërisë (në vijim pala pritëse) adresa në: Bulevardi Bajram Curri, Tiranë, e përfaqësuar nga Drejtues Madhor Haki ÇAKO, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë;

Neni 2

1. Pala dërguese, dërgon nga 6 (gjashtë) punonjës policie të trafikut rrugor dhe 3 (tre) automjete të loguara të Policisë së Kosovës në Shqipëri, për periudhën nga 01.07.2017 deri më 31.08.2017, në periudha të ndara por jo më të shkurta se 10 (dhjetë) ditë;
2. Zyrtarët policor të trafikut rrugor të palës dërguese, së bashku me punonjësit e Policisë Rrugore të palës pritëse, do të kryejnë shërbime të përbashkëta në territorin e Republikës së Shqipërisë, më konkretisht për:
 - 2.1. Aplikimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira të policimit rrugor,
 - 2.2. Kryerjen e shërbimeve policore për disiplinimin e lëvizjes së përdoruesve të rrugës dhe parandalimin e aksidenteve rrugore,
 - 2.3. Rritjen e parametrave të sigurisë rrugore për përdoruesit e rrugës,
 - 2.4. Rregullimin e trafikut rrugor dhe aplikimin e sanksioneve administrative, për ndëshkimin e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor.
3. Zyrtarët policor të palës dërguese, gjatë qëndrimit në Shqipëri dhe gjatë kryerjes së aktiviteteve në zbatim të detyrave funksionale të tyre, nuk kanë kompetenca policore ekzekutive dhe nuk mund të ndërmarrin aktivitete, për të cilat është kompetent oficeri i palës pritëse.
4. Gjatë kryerjes së shërbimeve policore, zyrtarët policor të palës dërguese, do të jenë me uniformë policore të shtetit të tyre.
5. Personeli policor duhet të jetë i kompletuar me uniformë policore, mjete rrugore të uniformuara dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve policore.
6. Mjetet teknike për përcaktimin e normave të sjelljes, nga përdoruesit e rrugës (radar dhe etilometra), do të planifikohen me shërbim nga pala pritëse, sipas modaliteteve të përcaktuara në aktet normative të vendit pritës.

Neni 3

Pala pritëse do të njohë zyrtarët policor të *palës dërguese* me aktet normative që përcaktojnë rregullat e qarkullimit rrugor, në Republikën e Shqipërisë, procedurat standarte të shërbimeve të Policisë Rrugore dhe kushtet specifike të punës të shërbimit të Policisë Rrugore gjatë sezonit turistik.

Neni 4

1. Planifikimi në shërbim i zyrtarëve policor të *palës dërguese*, bëhet nga struktura e Policisë Rrugore të Drejtorisë Vendore të Policisë, ku do të vendoset me shërbim, në përputhje me rregullat e organizimit të këtij shërbimi.
2. Gjatë kryerjes së shërbimeve policore, zyrtarët policor të *palës dërguese*, duhet të zbatojnë procedurat standarte të punës të shërbimit të policisë rrugore.
3. Zyrtarët policor të *palës dërguese*, së bashku me mjetet e tyre rrugore dhe teknike për përcaktimin e normave të sjelljes, planifikohen me shërbim nga pala pritëse, në përputhje me nevojat dhe gjendjen e trafikut.
4. Në raste të kryerjes së shërbimeve për përmbushjen e detyrave urgjente, zyrtarët policor të *palës dërguese*, duhet të jenë në gatishmëri për kryerjen e detyrave në çdo kohë, në përputhje me urdhrat e dhëna.
5. Të gjitha vërejtjet e zyrtarëve policor të *palës dërguese*, do t'i trajtojë shërbimi i autorizuar i *palës pritëse*, në përputhje me legjislacionin kombëtar të *palës pritëse*.

Neni 5

1. Gjatë kryerjes së shërbimeve të policisë rrugore, patrulla policore do të përbëhet nga një zyrtar i *palës dërguese* dhe një punonjës i policisë rrugore të *palës pritëse*.
2. Punonjësit e policisë, kryejnë shërbimin në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknikat e kryerjes së shërbimeve duke mbështetur njëri tjetrin, gjatë ndërhyrjeve në trafik dhe kontrolleve që ushtrojnë.
3. Zyrtarët e *palës dërguese*, janë të detyruar të marrin pjesë, bashkë me punonjësit e policisë së *palës pritëse*, në trajnimin e efektivit që kryhet para marrjes së shërbimit.
4. *Pala pritëse* do të sigurojë për zyrtarët e *palës dërguese* vendbanim, ushqim dhe transport lokal falas si dhe karburant për automjetet e Policisë së Kosovës gjatë qëndrimit në Shqipëri.
5. Gjatë kryerjes së shërbimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, zyrtarët e *palës dërguese* janë përgjegjës për veprimet që kryejnë në lidhje me statusin juridik në punë dhe përgjegjësinë që ata kanë. Sanksionet administrative dhe penale, aplikohen sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 6

1. Të gjitha detyrat, të cilat kryhen nga zyrtarët e *palës dërguese*, koordinohen nga *pala pritëse*, konkretisht nga drejtuesi i Sektorit të Policisë Rrugore në Drejtorinë Vendore të Policisë.
2. Zyrtarët policor të *palës dërguese* për punën që kryejnë, janë përgjegjës para mbikëqyrësve policor të *palës pritëse dhe palës dërguese*.

Neni 7

Pala pritëse është përgjegjëse për të gjitha çështjet administrative lidhur me menaxhimin e këtij shërbimi dhe me detyrat që do të kryejnë zyrtarët policor të *palës dërguese*, gjatë periudhës së shërbimit në Shqipëri.

Neni 8

1. *Pala pritëse*, në bazë të propozimit të Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, ku *pala dërguese*, është planifikuar dhe kryen shërbimin, mund të ndërpresë qëndrimin në Shqipëri të zyrtarëve policor të *palës dërguese* për këto shkaqe:
 - 1.1. Për mospërbushje të detyrimeve të përcaktuara në këtë memorandum.
 - 1.2. Moskryerjes së detyrave në mënyrën dhe kohën e duhur, pa dinjitet dhe në kundërshtim me procedurat standarde të punës të shërbimit të policisë rrugore.
 - 1.3. Sjelljen në kundërshtim me etikën policore dhe profesionale.
 - 1.4. Veprimet në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.
2. Raportin përkatës në lidhje me ndërprerjen e qëndrimit i bazuar në fakte objektive, Policia Shqiptare ia dërgon *palës dërguese*.

Neni 9

Pala pritëse në zbatim të Ligjit nr.74/2014 (neni 40), -"Për armët", u lejon hyrjen e zyrtarëve policor të *palës dërguese* sipas listës së poshtëshënuar në vendin tonë.

Nr	Emër Mbiemër	Nr.Letërnjoftimit	Lloji i Armës	Nr. Armës	Sasia e Municionit	Targa e Mjetit
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Neni 10

1. *Pala pritëse* bën vlerësimin e nevojës së vazhdimit të bashkëpunimit policor lidhur me dërgimin e përkohshëm të zyrtarëve policor të *palës dërguese* në Shqipëri gjatë sezonit turistik 2017.
2. Vendimin lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit të ardhshëm në këtë fushë, *pala pritëse* do t'ia dërgojë *palës dërguese* jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, përpara ditës së ndërprerjes së dërgimit të përkohshëm të zyrtarëve policor të *palës dërguese*.


Neni 11

1. Ndryshimi, apo plotësimi i mundshëm i kësaj marrëveshje bashkëpunimi bëhet me pëlqimin e palëve. Përfaqësuesit teknik mes palëve janë Drejtorët e Policisë Rrugore përkatëse.
2. Mosmarrëveshjet, të cilat rrjedhin gjatë zbatimit të këtij memorandumi, do të zgjidhen me mirëkuptim.
3. Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe e humbet fuqinë ditën e gjashtëdhjetë (60) pas përfundimit të periudhës së caktuar në nenin 2 paragrafi 1 të këtij memorandumi.

Neni 12


Nënshkruar me 30.06.2017 në katër (4) origjinale, dy (2) në gjuhën shqipe dhe dy (2) në gjuhën serbe, ku të gjitha tekstet janë identike.

PËR POLICINË E KOSOVËS


z. Shpend MAXHUNI
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës



PËR POLICINË E SHQIPTAR


Drejtues Madhor Haki ÇAKO
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Shqiptar

